




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. **2-D/DPK** Nr. Prot. **01-4821/14**
Dep. **02** Br. Prot. **16.12.2014**
Nr. i faq. **02** Data **16.12.2014**
Broj stranica **02** Datum **16.12.2014**
Nr. pages **02** Date **16.12.2014**
PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	10.12.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Genc Bashota – Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Prishtinës.
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Bashota

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-4118/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; *”bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin “rast për rast të interesave”, (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).*

Kërkesa e juaj (DPK-DPKI-03-4118/14), ka të bëjë me sqarimin, respektivisht marrjen e një opinionit nga Agjencia kundër Korrupsionit, lidhur me një situatë të cilën ju keni kërkuar sqarim se a paraqet konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik si Drejtor për ekonomi dhe zhvillim dhe në të njejtën kohë të qenurit anëtar i organit drejtues në një ndërmarrje të huaj.

Nga informacionet mbi biznesin "Croatia Osiguranje d.d" shihet se bëhet fjalë për një shoqëri aksionare e themeluar në Kroaci e cila në Kosovë vepron si shoqëri aksionare.

Për këtë rast janë analizuar edhe dokumentet bazë që e rregullojnë fushë veprimtarinë e Drejtorit të Ekonomisë dhe Financave (komuna e Prishtinës), Statutin e Komunës së Prishtinës dhe Ligjin për Vetqeverisjen lokale.

Për këtë rast ne kemi kërkuar edhe informacione shtesë - Statuti i Kompanisë Croatia Sigurimi, si dhe struktura e aksionarëve të kësaj kompanie (DPK/DMP-03-4352-14).

Përndryshe këtë situatë me së miri dhe me kompetencë e rregullon Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04-051), i cili ushtrimin e njëkohësishëm të këtyre dy funksioneve e cilëson si "Mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik".

Neni 15 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, shprehimisht thotë:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private."

Ky është edhe rekomandimi që ju bënë Agjencia kundër Korrupsionit për rastin tuaj konkret.

Përveq kësaj duhet t'ju rikujtojmë këtu edhe një herë se, si zyrtar i lartë, jeni të obliguar që kurdo që shfaqet situata e konfliktit të interesit (rast pas rasti) ta bëni deklarin e interesave.

Ky obligim i juaji ligjor bazën e ka po ashtu te Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në tri paragrafe të nenit 13, si vijon:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konfliktit të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.
3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.

Me respekt,